

BIBLIOTEKA

E

85H-31

T-83

GJIROKASTER

SHIFRA



PËRRENJTË

PERTEF ISUFI

ROMAN

891. P83 - 31

T. 83

PERTEF ISUFI

S

PËRRENJTË

ROMAN

~~5627~~



7871

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

KAPITULLI I PARË

Batos as që i vajti në mendje fare të pyeste se kush ishte pas derës. «Ndonjë myshteri, mendoi tek ecte çalë-çalë për nga dera, që i dhimset vllaga e punës.» E, sipas zakonit të tij i hoqi shulin derës dhe e hapi krejt njërin kanat. Përpara tij, nën dritën e zbetë të hënës, ai shqoi dy silueta njerëzish.

— Tungjatjeta, xha Bato! — përshëndeti ai që u ndodh më pranë derës. Pas tij përshëndeti dhe ai tjetri.

Batua po mendohej. Nuk ishte i bindur në e kish dëgjuar ndonjëherë zërin e atij që foli i pari...

— Mirësevini, — ua ktheu më në fund Batua ftohtë.

— A pret mysafirë? — pyeti ai që përshëndeti i pari.

Batua ja ktheu aty për aty:

— Këtu nuk është vend për mysafirë. Kjo derë është mësuar të presë vetëm myshterinj, bukë...

— Po kusar? — foli i panjohuri.

— Ehë, s'ka mbetur gjësendi për kusarët, veç katër mureve.

Të panjohurit qeshën.

— Siç po e sheh, ne jemi kallinj pa bukë, prandaj, si të duash.

— Bujrum, bujrum, — foli me të njëjtën ftohtësi millonai, — se llafet e tepërta janë vërtet pa bukë. — Dhe u hapi udhë, që të futeshin brenda, pa e mbaruar fjalën.

«Epo. ç'djaj të jenë këta? — i shkoi nëpër mendje

Batos, ndërsa po mbyllte derën. — Kusarë nuk janë një herë. Se ata lanetër njihen që në të folur... Mos janë nga ata komitet?... Le të jenë ç'të jenë, tani u pa kjo punë! — Dhe vajti pas tyre.

— Qysh je, more xha Bato, qysh ke qenë, a?

Plaku rrudhi ballin. Tani sepse ju duk më i njohur ai zë. Mori kandilin dhe ja afroi te fytyra atij që posa foli.

— Po pse, ore, ti qafir paske qenë? Dhe nuk më dhe hiç të njohur, more i pahair, hë!.. Uluni, de, uluni dhe mos më nusëroni kështu!

Mustafai qeshi dhe e ngjeshi përsëdyti pas gjoksit, ndërsa e puthte ndër faqet e parruara.

— Si gjemba drize i ke këto të shkreta qime, — i tha pastaj me të qeshur.

— Dhe në i kam, i kam për veten time dhe për plakën, — ja ktheu Batua. — Se mos të vura litarin në fyt që të më puthje pa derman!.. Po këtë nga e kemi? Si shumë nusëroka ky.

— Një shoku im. Nga këto anë është. Quhet Aleks.

— Qysh, qysh, ma the atë emrin?... Aleks? Epo, mos na gënje tani, se nga anët tona nuk ka kësi emrash. Mustafai buzëqeshi.

— Nuk të gënjej, xha Bato.

Plaku seç murmuriti. U ulën mbi thasët. Batua nxori kutinë e duhanit dhe ja zgjati së pari Aleksit.

— Prit, — i tha, dhe nxori kuletën e tij të vjetër, të lidhur me një spango. — Më duket se më kanë mbetur dhe nja dy letra. I ruaj për ndonjë mik, se vetë e pi me çibuk. Kjo letra çoj ma jep si kashtë fare të mallkuarin.

— Domethënë, ne na quan miq, në mos gabohem, — e ngacmoi për herë të parë Aleksit.

Batua ndërroi pamje një çast.

— S'të njoh. Këtë njoh unë, — dhe bëri me kokë nga Mustafai. — Dhe me këtë një herë jam pjekur. Çoj më është dukur me kripë ky lanet. — E vështroi një hop në kokërdhok Aleksin, pastaj i shkeli synë Mustafait. Të porsaardhurit qeshën.

— Të thashë, të thashë, — ju drejtua Mustafai Aleksit. — Dhe hajde mos ta duash me shpirt këtë njeri! Millonai ngrysi vetullat.

— Hë, ç'i the, more haramsëz, apo që nuk do të më jepnit të njohur!

— Ashtu i thashë, — e ndërroi bisedën Mustafai, buzagaz. — Do t'i japim një të trembur xha Batos, që të mos e harrojë mot e jetë...

— O, na bëre për të qeshur, s'e sheh, a! Do trembte lugati lugatin.

Mustafai dhe Aleksit zunë të qeshnin, pa ja hequr sytë plakut që dinte të mbahej aq serioz.

— Qenkeni me të vërtetë plak i lezetshëm, — foli përmes të qeshurit Aleksit. — Më ka folur Mustafai për juve, por nuk e merrja me mend.

Batua i nguli një shikim sa të vëngër, aq dhe të rreptë e qortues.

— Jo, more, — ju kërkimit pastaj, tek e vështronte në dritë të syrit. — Ashtu, hë! Nuk qenke fare pa të, jo.

Batua ja tha me aq seriozitet këto fjalë, sa që Aleksit i ngriu e qeshura ndër buzë. Kurse Mustafai vazhdonte të qeshte pa teklif dhe me shpirt.

— Të më falësh, xha Bato, por nuk ta pata për të keq, — u mundua të çfajësohej Aleksit.

Batua ju kthye Mustafait:

— Doni të hani?

— Po qe se të ndodhet gjësendi.

— Bukë triditëshe, e mykur.

— S'ka gjë, e pranojmë.

— Thatë fare.

— S'kemi asnjë kundërshtim.

Batua tundi kokën dhe nisi të ngrihej me ndihmën e shkopit. («A, po ti ta ha kokën me të mirë, more i paudhë i çeqos!»)

Mustafai nisi të kundronte rrethrotull.

— Pse nuk punon mulliri, xha Bato? — e pyeti.

— Çë, gur, a?-ja ktheu Batua që andej tutje. — Është katandisur kaposhi një thellë, biro. Në tërë këtë

goxha krahinë, të të katandiset mulliri me nja dhjetë myshterinj në ditë, kjo s'ka bërë vaki. Të vesh duart në kokë, ore! — Dhe u hapi përpara një thes të mbledhur. Kulaçi që kishte mbështjellë në të, avullonte. E ndau në copa dhe iku përsëri.

Pas pak u kthye me një kupë të drunjtë mes duarve. U ul në vendin e tij. Mustafai mori një copë kulaç dhe e nduku. Tundi kokën dhe qeshi.

— Hë, sikur na the se kishe bukë të mykur.

Batua s'ja vuri veshin. «E kush do të ishte ai, që do të të nxirrte bukë të mykur ty, more haramsëz i çeqos!» — tha me mendje. I hoqi kapakun kupës dhe e lëshoi me kujdes midis copave të bukës.

— Po këtë, ç'e ke, xha Bato? — e pyeti Mustafai.

— Një çikë shëllirë. Ma solli sot një myshteri i përtejlumit. Keni një çikëz fat, keni, se do ta hanit vërtet thatë.

Mustafai ngjau një kafshatë në shëllirën e gjalpiti. Ashtu bëri dhe Aleksii.

— Pse nuk thua që na kënaqe, — foli duke u mbllacitur me oreks Mustafai. — Kushedi sa kam pa shijuar kulaç të grunjtë të ngrohtë me shëllirë. Ta hoqëm nga goja.

Batua i hodhi një vështrim të shpejtë dhe qortues.

— Mos llototit kur ha, se po na mbytesh, atë të bësh, — ju shkreh pastaj, tek ngjyente bukën.

Dy të tjerët qeshën.

— S'ja kemi frikën kësaj, — foli Mustafai, — se Poçemi ka ujë sa të duash.

— Nuk kisha ngrënë ndonjëherë bukë me shëllirë, — foli Aleksii, pa ju drejtuar askujt. — Qenka e shijshme.

— Mua më pëlqen shumë, — u hodh shoku i tij.

— O, gjë e bukur fort, s'e shikoni! — ua priti plaku. Pastaj ju drejtua Aleksit: — Nuk di nga ju kemi e ç'zakone keni, mor bir. Se, i themi një fjale ne, fshat e zanat, derë e tabijat. Një gjë të dish ti. Po erdhe në këto anët tona dhe të nxorën për të ngrënë bukë me shëllirë, me

reani apo me urrël, dije mirë se ka vajtur tek nuk mban më. Ja kështu, mor bir!

Aleksj vështroi Mustafanë. Ky i fundit pohoi me kokë. Nuk foli, se e kishte mbushur gojën plot. Kishte shumë uri. Bile Batua, tek e shikonte ashtu, duke i futur kafshatat njerën pas tjetrës, tha me vete: «Të shkretët djem, kushedi që kur kanë pa ngrënë!...»

— Kasëmin, a ta ka zënë syri këto ditë? — pyeti Mustafai.

— Këtu u gdhi njënatzaj, — foli Batua. — Ja, sikundër ju, dhe ai vërtitej ditë e natë këtyre anëve. I duket sikur çoç bën, por një vërë në ujë po bën dhe ai...

— Hë, — qeshi Mustafai dhe vazhdoi, më tepër për ta ngacmuar. — E di unë, e ke zënë zët ti atë, qëkurse u bë shkak të mos vrisje Syrja aganë.

— O, gjë të bukur fort bëri, s'e sheh, a! Aferim i goftë! — shfryu plaku dhe nisi të mbushte çibukun.

Mustafai i foli seriozisht:

— Akoma nuk e ke kuptuar se nuk do të fitoje asgjë me atë rrugë që kishte vendosur? Ja, i zure pusi dhe e vrave. Në rregull gjer këtu. Po, a nuk më thua, do fitoje gjësendi pas kësaj?

— Nuk kam nevojë për fitime unë. Të më kënaqej një herë shpirti, pa në djall le të vente, mjaft që të shfryja dufin tim!

— Po do shuheshe me kuç e me maç, pa mirë.

Batua i nguli një shikim të vëngër, gjë që donte të thoshte se nuk ja vlente të vazhdohej më tej ajo bisedë.

— Keni ndonjë haber tjetër ju, ja, atë shihni, — foli pastaj Batua. — Nga ishit, a, nga po veni, a. Që inati është dëm i kokës, këtë e di unë...

Dy shokët qeshën.

— Të gjitha të reja janë tani, xha Bato, se plakat po vdesin, — e mori fjalën Mustafai. — Mirëpo, ke parë ti, që na ka pjellë groshi, sepse këto të rejat po kërkojnë ca gjëra që plakave s'u vjen hiç mirë...

— E, e! — ju kanos Batua. — Mos më llafos çapraz

mua, por vençe. Nuk marr vesh ashtu, unë, majë më majë e degë më degë.

— Ka filluar të valojë kazani, xha Bato, — e mori fjalën Aleksis. — Është ngritur djemuria, tërë populli, dhe po kërkon liri, drejtësi.

— Çfarë drejtësie, atë që e ka ngrënë bisha, a?

— E, atë.

Batua ndezi çibukun dhe e hoqi nja dy herë radhazi.

— Ne e dimë që ti e do, se jemi llafosur një natë të tërë bashkë, apo harrove? — tha Mustafai.

— Eh, jo more, jo nuk harroj kollaj unë, sidoqë po na rrjedhin trutë nga pleqëria.

Mustafai buzëqeshi.

Batua psherëtiu.

— Qysh thoni, a do të merrni nga një sy gjumë tani, djema?

— Qejfi na i ka dhe shpirti na i do, or xha Bato, por kemi shumë udhë për të bërë.

— Si të doni, po mirë do të qe. Merak të mos kini këtu.

— Për këtë as që merakosemi, se e dimë te kush kemi ardhur, — tha Mustafai e pas një hopi ju drejtua shokut: — Si thua, Leksi, shtrihemi sa të qetësohemi pak?

Tjetri u tendos dhe ngriti supet, sikur desh të thoshte: «Nga ti varet, si të duash».

Mustafai vështrroi orën.

— Mirë, rrimë ndonjë sahat, — tha pastaj.

— Mirë do bëni, biro, se ju ka telekosur udha. Shtrihuni në atë shtratin tim. Është ca i gjerë ai, besoj se ju merr të dyve.

— Po, kulaçin e ngrohtë dhe shëllirën t'i hëngrëm; tani të të zaptojmë dhe shtratin! — u hodh Mustafai. — Po shtrihemi këtu, ne, mbi thasët...

— Shkoni, more, dhe shplodhuni rehat një copë herë, atë të bëni, se mua as që më flihet. Veç ç'të bëj që s'kam ç'bluaj, kjo ma punon keq mua!.. Shkoni, shkoni, se do ju marrë të dyve. Si petë byreku jeni edhe juve.

Mustafai i bëri shenjë me sy Aleksit. Pastaj ju drejtua plakut:

— Siç duket, e ke bërë të gjerë që të flesh ndonjëherë edhe me plakën, hë?

Për herë të parë gjatë asaj nate Batua mezi vuri buzën në gaz.

— Or, po nuk vjen, lanetja, se vallahi nuk do të qe keq, — ja ktheu pastaj shakasë.

Dy të rinjtë ja plasën gazit.

— Iku, ore, iku vapa me gushtin. E kam bërë të gjerë se xheku më vjen nganjëherë ai djali i madh.

Desh s'desh, më në fund Batua u bind që të shtrihej vetë në shtrat. Mustafai me Aleksin zunë të rregulloheshin dosido aty, mbi thasët.

— Xha Bato! — thirri Mustafai, pasi qe shtrirë prap-tas mbi thasët, me duart të kryqëzuara pas kokës.

— Hë, fol, mor bir.

— Atë ujdinë, besoj se nuk e ke harruar, hë? Se po afron ajo ditë që mezi po e pret, de.

Batua nuk foli. Po mendohej duke ndukur mustaqet. Jo se nuk i kujtohej ujdia, që posa i përmendi Mustafai, por sepse e brente diçka tjetër. Po, meqë të dyja këto binin në kundërshtim me njera tjetrën, Batua as që donte t'i flitej për ujdinë. Në të vërtetë, kur i kishte folur gjerë e gjatë Mustafai, para ca muajsh për atë ujdë, Batua nuk kishte pranuar. Bile ja kishte shprehur hapur Mustafait. Dhe biseda qe zgjatur e qe zgjatur rreth asaj ujdie, saqë millonai e kishte mbyllur përbrenda bindjen e vet dhe nuk e kishte zgjatur më tej. Mustafai ngulte këmbë në të tijën. Mendimet e tij të qarta Batua ishte e pamundur t'ja hidhte poshtë. Fjalët e Mustafait ishin si gozhdë. Kështu mendonte Batua.

— U gdhifshi mirë! — tha më në fund Batua dhe u rregullua në shtrat.

Mustafai buzëqeshi.

— Ç'njeri i çuditshëm! — pëshpëriti Mustafai.

— Po të mos më kishe folur më parë për të, zor se do ta kuptoja këtë njeri, — ja ktheu po me të pëshpëri-

tur Aleksis. — Ai ka një vrazhdësi që të tmerron, kurse zemrën...

— Hë, — u hodh tjetri, — pikërisht këtu qëndron kyçi i sekretit të këtij njeriu, se pamja e jashtme nuk të tregon asgjë nga ato që fshihen në shpirtin e tij. Çudi, sa të ngatërruar janë njerëzit!

— Vërtet.

— Jo, po të bredhësh këtej, si puna jonë, ndesh plot të tillë. Në përgjithësi, jeta i ka bërë njerëzit shumë të ashpër e të vrazhdë në pamje. Por, sidoqoftë, xha Batua ka diçka të veçantë, diçka të tijën, nga të gjithë fshatarët që kam ndeshur dhe që kam patur rast të njoh. Kjo është një bazë mjaft e mirë për të ardhmen e afërt, por e keqja është se nuk i mbushet mendja!

— Do jetë me të vërtetë një bazë e shëndoshë për ne. Duhet ta ruajmë. Aq më tepër që është njeriu ynë.

— Por hajde dhe mbushi mendjen, se! Siç të kam thënë, biseduam një natë të tërë bashkë. Për të gjitha më dëgjonte dhe më besonte thuajse verbërisht, por, kur erdhi fjala në këtë pikë, ngulte këmbë në të tijën. «Një herë ju dëgjova juve, — më tha, dhe e kishte fjalën për Kason, — që nuk ja hodha trutë në erë neqezit Syrja aga, pa, kur të vijë ajo ditë, sikur qeni qepën të hajë!...» I dhashë e i mora, por më kot. Jo se nuk e kuptonte rëndësinë e qëndrimit në mulli, por «le të vijë ndonjë tjetër këtu», më thoshte, «unë nuk do ta kem më këtu vendin. Kam hesape për të larë». — Mustafai heshti. Ata flisnin ngadalë e shtruar. Gjumi rëndonte qepallat dhe lodhja po ndjehej.

— Qënkemi lodhur shumë, — foli Aleksis. — Tani po e ndjej. Po më therin këmbët.

— Doemos. I thonë rreth dyzetë kilometra rrugë, jo shaka. E mira e të mirave do të ishte sikur të mos kishim qëndruar fare. Nuk do ta ndjenim dhe aq lodhjen. Por, të kalosh këtej, dhe të mos kthehesh tek xha Batua, gjë që s'bëhet. Pastaj ishim dhe të pangrënë, dreqi e mori!

— O, me siguri, po të mos hanim gjësendi dhe këtu, nuk dihej se kur do të piqeshim me bukën pastaj, —